



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PRESEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	22.07.2025
NR/BR.	01.197/25
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës 
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt 
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim – Vendim për aprovimin e memorandumit të bashkëpunimit me OJQ-të, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Shtëpia Ime" – Ferizaj

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës përmes Komitetit për Politikë dhe Financa i propozon Kuvendit të Komunës të marrë:

V E N D I M

Për;

1. Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit në mes Komunës së Ferizajt dhe OJQ-ve, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Shtëpia Ime" – Ferizaj.
2. Mirëkuptimit ka për qëllim krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimit të trajtimit të grave viktime të dhunës në familje dhe rasteve të ngjashme, shërbim i cili do të ofrohet nga Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Shtëpia Ime" – Ferizaj nën monitorimin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të Komunës së Ferizajt.

3. Ky memorandum lidhet në afat prej 10 viteve.
4. Objekti për ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e viktimave, caktohet zyra e vendit në Zaskok i ndërtuar në ngastrën kadastrale 638-0 Z.K. Zaskok, pronë e Komunës së Ferizajt. Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “Shtëpia Ime” – Ferizaj, shërbimin do ta ofroj pa pagesë ndërsa buxhetin për aktivitete do ta siguroj përmes donatorëve, do të sigurojë shfrytëzimin efikas të fondeve të mbledhura për këtë projekt, si dhe do të raportojë donatorëve për aktivitete si dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - QPS-së – Komuna e Ferizajt.
5. Monitorimi i këtij memorandum bëhet nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe QPS.
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Komunës së Ferizajt.

Të bashkangjitur gjeni;

- *Memorandumin e mirëkuptimit.*




REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	22.07.2025
NR/BR.	01.197/25
PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës së Ferizajt
PËRMES/PREKO/THROUGH	Xhavit Zariqi, Kryesues i Kuvendit të Komunës 
NGA/OD/FROM	Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt 
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim –Vendim për aprovimin e memorandumit të bashkëpunimit me OJQ-të, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Shtëpia Ime" – Ferizaj

Në bazë të nenit 58 pika h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 51 pika 2.9 të Statutit të Komunës 01.Nr.50 të datës 28.06.2013, Kryetari i Komunës përmes Komitetit për Politikë dhe Financa i propozon Kuvendit të Komunës të marrë:

V E N D I M

Për;

1. Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit në mes Komunës së Ferizajt dhe OJQ-ve, Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Shtëpia Ime" – Ferizaj.
2. Mirëkuptimit ka për qëllim krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimit të trajtimit të grave viktime të dhunës në familje dhe rasteve të ngjashme, shërbim i cili do të ofrohet nga Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve "Shtëpia Ime" – Ferizaj nën monitorimin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të Komunës së Ferizajt.

3. Ky memorandum lidhet në afat prej 10 viteve.
4. Objekti për ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e viktimave, caktohet zyra e vendit në Zaskok i ndërtuar në ngastrën kadastrale 638-0 Z.K. Zaskok, pronë e Komunës së Ferizajt. Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve “Shtëpia Ime” – Ferizaj, shërbimin do ta ofroj pa pagesë ndërsa buxhetin për aktivitete do ta siguroj përmes donatorëve, do të sigurojë shfrytëzimin efikas të fondeve të mbledhura për këtë projekt, si dhe do të raportojë donatorëve për aktivitete si dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - QPS-së – Komuna e Ferizajt.
5. Monitorimi i këtij memorandum bëhet nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale dhe QPS.
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Mirëqenie Sociale e Komunës së Ferizajt.

Të bashkangjitur gjeni;

- *Memorandumin e mirëkuptimit.*

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

HYRJE

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime - Ferizaj, me Komunën e Ferizajt kanë bashkëpunim të jashtëzakonshëm me njëra tjetrën, dhe si rezultat i kësaj qëllimi kryesor i këtij memorandum është vazhdimi i bashkëpunimit në mes Komunës së Ferizajt dhe Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime – Ferizaj.

Pëmes këtij bashkëpunimi Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime – Ferizaj do të forcojë infrastrukturën e tanishme të ofrimit të shërbimeve aktuale për qytetarët e Regjionit të Ferizajt, viktimë të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.

Neni 1: Palët e memorandumit të mirëkuptimit

Ky Memorandum i Mirëkuptimit (MM) është ndërmjet:

- Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime – Ferizaj dhe
- Komunës së Ferizajt

Neni 2: Qëllimi i Memorandumit të Mirëkuptimit:

Memorandumi i Mirëkuptimit ka për qëllim krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimit të trajtimit të grave viktimë të dhunës në familje dhe rasteve të ngjashme, shërbim i cili do të ofrohet nga Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime – Ferizaj nën monitorimin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të Komunës së Ferizajt.

Objekti për ofrimin e këtij shërbimi për mbrojtjen e grave viktimë të dhunës në familje dhe rasteve të ngjashme do të jetë objekti i Zyres së Vendit në Zaskok, i ndërtuar në parcelën kadastrale 638-0 Z.K. Zaskok, pronë e Komunës së Ferizajt.

Ky memorandum është i rëndësishëm së veçantë që thekson angazhimin dhe përkushtimin e shoqërisë dhe institucioneve ndaj mirëqenies së të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore. Ky memorandum është shenjë e vullnetit të lirë për të përmirësuar dhe krijuar mjedis të përshtatshëm për ofrimin e shërbimeve sociale – profesionale në strehimin dhe sigurinë e të mbijetuarave të dhunës për Regjionin e Ferizajt. Ky program arrihet falë kushteve që do të ofrohen përmes hapësirës së përshtatshme, teknologjisë, infrastruktures dhe mjeteve tjera të nevojshme përcjellëse.

Qëllimet kryesore të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit janë si në vijim:

- Strehimi dhe siguria për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore:
- Riorganizimi i objektit duke përfshirë zgjerimin e tij si dhe duke pajisur me infrastrukturë të nevojshme për ofrimin e shërbimeve të QMGF. “Shtëpia Ime” ka si



objektivë ofrimin e një ambienti të sigurtë, të rehatshëm dhe të përshtatshëm për këtë grup. Renovimi i këtij objekti do të përmirësojë cilësinë e jetës së të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.

- Përfshirja dhe Integrimi në Shoqëri: Ky projekt synon të jetë një hap i theksuar drejt ofrimit të shërbimeve më cilësore sociale-profesionale për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, dhe do të ju mundësojmë atyre të ndjehen se janë të sigurta dhe pjesë e rëndësishme e shoqërisë.
- Ofrimi i Shërbimeve dhe Mundësive të Barabarta: Memorandumi synon të garantojë që të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore të kenë qasje të barabartë në shërbime të ndryshme, të tilla si strehimi, siguria, arsimi, trajnimi profesional, kujdesi shëndetësor, kulturor, dhe shërbime të tjera të nevojshme. Pikërisht ky objekt do të jetë një hap drejt rritjes së qasjes së tyre në sfera të ndryshme, përmes aktiviteteve që do të organizohen brenda dhe jashtë tij.
- Promovimi i Bashkëpunimit dhe Partneritetit: Ky memorandum poashtu është një tregues i bashkëpunimit të ngushtë mes Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime - Ferizaj dhe Komunës së Ferizajt, drejt ofrimit të një mjedisi të përshtatshëm për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore për Regjionin e Ferizajt. Ky bashkëpunim ndihmon në forcimin e partneritetit dhe solidaritetit ndërmjet të gjithë palëve të përfshira. Poashtu, me këtë bashkëpunim, promovohet një shembull tejet i duhur se sa shumë mund të ndihmojmë, kur bashkohemi drejt kauzave të mëdha, siç është parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna në familje.
- Si përfundim, mund të themi se ky memorandum përfaqëson angazhimin e përbashkët të shoqërisë dhe institucioneve për të siguruar një ambient të përshtatshëm dhe të mbështetur për këtë pjesë të komunitetit. Ky dokument shpreh synimin për të promovuar të drejtat e të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore, si dhe për të ndihmuar në ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse.
- Rastet e dhunës në familje referohen nga organet kompetente Gjykata, Prokuroria si dhe nga QPS-Ferizaj.

Neni 3: Fushat e bashkëpunimit të palëve të Memorandumit të Mirëkuptimit

Fushat e bashkëpunimit mes Komunës së Ferizajt dhe Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime - Ferizajt përfshijnë:

- ✚ Ofrimin e qëndrueshëm të shërbimeve rehabilituese të bazuara në bashkësi për të gjitha grupmoshat, duke përfshirë këtu të gjitha gratë, vajzat dhe fëmijët të mbijetuar të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore për Regjionin e Ferizajt;
- ✚ Ofrimin e qëndrueshëm të shërbimeve sociale të bazuara në komunitet për të mbijetuarat e dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore për Regjionin e Ferizajt;
- ✚ Qasjen multi-disiplinare dhe multi-sektoriale në ofrimin e shërbimeve;



- ✚ Aktivitete koordinuese në nivelin lokal dhe qendror;
- ✚ Aktivitete monitorimi, raportimi dhe vlerësimi të shërbimeve;
- ✚ Aktivitete planifikimi dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve.

Neni 4: Rolet dhe përgjegjësitë e palëve të Memorandumit të Mirëkuptimit

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime - Ferizaj :

1. Ofrimi i shërbimeve për të mbijetuarat e dhunës në baza gjinore.

1.1. Sigurimi i nevojave emergjente të të mbijetuarave të dhunës në baza gjinore.

- 1.1.1. Ofrimi i sigurisë për të mbijetuarat e dhunës në baza gjinore.
- 1.1.2. Ofrimi i akomodimit, ushqimit, veshmbathjes dhe higjienës për të mbijetuarat e dhunës në baza gjinore.
- 1.1.3. Vendosja e kontakteve me familjarët dhe institucionet.

1.2. Ofrimi i përkujdesjes shëndetësore për të mbijetuarat e dhunës në baza gjinore.

- 1.2.1. Vlerësimi i gjendjes shëndetësore të të mbijetuarave.
- 1.2.2. Sigurimi i trajtimit mjekësor, bazuar në raportin e vlerësimit.
- 1.2.3. Sigurimi i medikamenteve, bazuar në recetat e mjekut.
- 1.2.4. Dhënia e medikamenteve, bazuar në recetat e mjekut.
- 1.2.5. Organizimi i vizitave të rregullta mjekësore për gratë dhe fëmijët.
- 1.2.6. Vetëdijësimi i të mbijetuarave lidhur me rëndësinë e përkujdesjes shëndetësore.

1.3. Ofrimi i mbështetjes psikologjike për të mbijetuarat e dhunës në baza gjinore.

- 1.3.1. Organizimi i seancave individuale dhe grupore me të mbijetuarat.
- 1.3.2. Zhvillimi i planeve individuale të punës për të mbijetuarat.
- 1.3.3. Organizimi i seancave rehabilituese për gratë dhe fëmijët e mbijetuar të dhunës në baza gjinore.

1.4. Ofrimi i mbështetjes psiko-sociale për të mbijetuarat e dhunës në baza gjinore.

- 1.4.1. Organizimi i seancave psiko-sociale individuale dhe grupore për të mbijetuarat e dhunës.
- 1.4.2. Hartimi i planit të veprimit në bashkëpunim me DSHMS-në dhe QPS-në për të ardhmen e të mbijetuarave.
- 1.4.3. Organizimi i seancave rekreative për gratë dhe fëmijët.

1.5. Ofrimi i këshillimeve ligjore për të mbijetuarat e dhunës në baza gjinore.

- 1.5.1. Ofrimi i këshillave juridike.
- 1.5.2. Mbajtja e kontakteve me zyrën për Ndihmë Juridike Falas.

1.6. Ofrimi i shërbimeve edukative – arsimore për të mbijetuarat e dhunës në baza gjinore.

- 1.6.1. Mbështetja e grave për të përfunduar shkollimin në rastet kur janë afër diplomimit.
- 1.6.2. Sigurimi i vazhdimit të shkollimit të rregullt për fëmijët.
- 1.6.3. Organizimi i aktiviteteve edukative në strehimore.
- 1.6.4. Mbështetja e nxënësve në mësim nxënie dhe detyra të shtëpisë.
- 1.6.5. Organizimi i aktiviteteve rekreative edukative për fëmijë.
- 1.6.6. Organizimi i aktiviteteve artistike terapeutike.
- 1.6.7. Organizimi i aktiviteteve edukative për gratë analfabete.

2. Fuqizimi i të mbijetuarave të dhunës në baza gjinore.

2.1. Ngritja e kapaciteteve profesionale të të mbijetuarave të dhunës në baza gjinore.

- 2.1.1. Referimi i të mbijetuarave te zyra komunale për punësim.
- 2.1.2. Identifikimi i kapaciteteve profesionale të të mbijetuarave.
- 2.1.3. Vendosja e kontakteve me QAP-at dhe vazhdimi i edukimit profesional.
- 2.1.4. Organizimi i trajnimeve profesionale në strehimore bazuar në kapacitete te të mbijetuarave.

2.2. Mbështetja e të mbijetuarave të dhunës në baza gjinore për punësim dhe vetëpunësim.

- 2.2.1. Ofrimi i granteve të vogla për zhvillim të biznesit.
- 2.2.2. Identifikimi i mundësive për mbështetje financiare nga donatorë të ndryshëm të të mbijetuarave të dhunës.
- 2.2.3. Ndërmjetësimi për sigurim të vendeve të punës për të mbijetuarat.

2.3. Mbështetja e të mbijetuarave të dhunës për jetë të pavarur jashtë strehimores.

- 2.3.1. Referimi i të mbijetuarave te Drejtorati për Mirëqenie Sociale për sigurim të banimit.

3. Parandalimi i dhunës në baza gjinore.

3.1. Ngritja e vetëdijes së komunitetit dhe institucioneve për të luftuar dhunën në baza gjinore.

- 3.1.1. Organizimi i tryezave të rrumbullakëta me përfaqësues të institucioneve.
- 3.1.2. Prodhimi i materialeve vetëdijesuese.
- 3.1.3. Organizimi i fushatave vetëdijesuese.

3.2. Vetëdijësimi i të mbijetuarave të dhunës në baza gjinore mbi të drejtat e tyre dhe mekanizmat ligjore për të realizuar ato.

- 3.2.1. Organizim i seancave informuese lidhur me të drejtat ligjore të të mbijetuarave.

3.3. Ngritja e kapaciteteve të institucioneve për qasjen ndaj të mbijetuarave të dhunës në baza gjinore.

- 3.3.1. Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për qasje ndaj dhe trajtim të të mbijetuarave të dhunës.

- 3.3.2. Pjesëmarrja e vazhdueshme në mekanizmin komunal koordinues kundër dhunës në familje. MKKDHf
- 3.3.3. Koordinimi i punës me anëtarët e mekanizmit për ofrim të mbështetjes ndaj të mbijetuarave.

3.4. Përmirësimi i implementimit të kornizës ligjore për mbrojtjen e të mbijetuarave të dhunës në baza gjinore.

- 3.4.1. Avokimi i vazhdueshëm për ndryshim, plotësim dhe harmonizim të kornizës ligjore.
- 3.4.2. Avokim i vazhdueshëm për implementim të kornizës ligjore.
- 3.4.3. Monitorimi i vazhdueshëm i implementimit të kornizës ligjore.
- 3.4.4. Avokim për sigurim të qëndrueshmërisë financiare.

4. Ngritja e kapaciteteve të brendshme të strehimores.

4.1. Përmirësimi i funksionimit të brendshëm të organizatës.

- 4.1.1. Zhvillimi i dokumenteve të brendshme të organizatës.
- 4.1.2. Përpilimi i formularëve për prokurim dhe menaxhim të stafit.

4.2. Ngritja e kapaciteteve të stafit të strehimores.

- 4.2.1. Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të stafit për trajnim.
- 4.2.2. Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për stafin.
- 4.2.3. Marrja e praktikave të mira nga vendet e zhvilluara demokratike.
- Do të koordinojë punën mes palëve;
- Do të kujdeset për punimet, pagesat dhe procedurat e prokurimit.

Komuna e Ferizajt:

- Do të siguroj hapsirën për OJQ Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime - Ferizaj në objektin i cili është i ndërtuar në parcelën nr. 638-0 Z.K. Zaskok, Komuna e Ferizajt.
- Do të lejojë riorganizimin dhe zgjerim të objektit aktual për ta përshtatur për qëllimet e aktiviteteve, për çdo ndryshim OJQ Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime – Ferizaj duhet të paiset paraprakisht me leje nga Drejtoria për Urbanizëm.
- Do të marr përsipër pagesën e shpenzimeve komunale që lidhen me objektin (Energjia elektrike, ujësjellësi, mbeturinat, etj.);

Neni 5: Përfituesit

- Përfituesit direkt të shërbimeve do të jenë të gjitha gratë, vajzat dhe fëmijët të mbijetuar të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore.
- Përfituesit indirekt janë popullata e gjerë e Regjionit të Ferizajt, të cilët do të përfitojnë nga shërbimet e fuqizuara sociale të bazuara në bashkësi.

Neni 6: Përgjegjësitë financiare

- Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime - Ferizaj shërbimin do ta ofroj pa pagesë ndërsa buxhetin për aktivitete do ta siguroj përmes donatorëve, do të sigurojë



shfrytëzimin efikas të fondeve të mbledhura për këtë projekt, si dhe do të raportojë donatorëve për aktivitete si dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - QPS-së – Komuna e Ferizajt.

Neni 7: Konfidencialiteti

Gjatë ofrimit të shërbimeve të ofruara në bashkësi do të respektohet konfidencialiteti i secilës informatë që ka të bëjë me individë apo grup përfitues nga projekti. Përmbajtjen e secilit dokument duke përfshirë edhe bazën e të dhënave kompjuterike mund të lëshohen vetëm nga personat e autorizuar sipas rregullave të caktuara nga Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime – Ferizaj.

Neni 8: Kohëzgjatja

Ky Memorandum Bashkëpunimi do të jetë i vlefshëm në një afat prej 10 viteve.

Ky memorandum mund të ndërprehet me paralajmërim paraprak prej 60 ditëve nga Komuna e Ferizajt nëse OJQ Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Shtëpia Ime – Ferizaj, nuk ju përmbahet kushteve të këtij memorandum apo Komunës së Ferizajt objekti i duhet për ndonjë projekt në interes të përgjithshëm.

Neni 9: Hyrja në fuqi

Ky memorandum do të nënshkruhet pas miratimit në Kuvend Komunal dhe prodhon efekt juridik ditën kur vendimi për miratimin e tij nga Kuvendi Komunal është i plotfuqishëm. Për monitorimin e këtij memorandum përkujdeset Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - QPS Ferizaj.

Për QMGF Shtëpia Ime - Ferizaj:

Sevdije Kasumi – Bunjaku

Drejtor Ekzekutiv

Për Komunën e Ferizajt:

Agim Aliu

Kryetar i Komunës

Ferizaj, Datë: ____ . ____ . ____ :